

Interviste e Kryetarit te Prezences se OSBE-se ne Shqiperi, Ambasadorit Osmo Lipponen

Nga Cerciz Loloci

- **Zoti Ambasador, do te donim t'ju pyesnim fillimisht per ecurine e zhvillimeve shqiptare?**

Une do te paraqes raportin tim para Keshillit te Perhershem te OSBE-se ne Viene ne fillim te qershorit, por do te bej disa komente te pergjithshme ketu. Problemet me te cilat po haset Shqiperia jane te medha. Jane bere perpjekje te shumta per t'i zgjidhur ato, por perparimi ka qene i ngadalte, ose nuk eshte arritur ende. Nuk jane hedhur akoma themelet per nje zhvillim te shpejte. Megjithate, sistemet politike dhe gjyqesore/ligjore ofrojne shanse, ndersa marreveshja Nano-Berisha dhe puna e komisionit dypalesh per reformen zgjedhore premtojne kulture politike. Zhvillimi politik, ekonomik dhe shoqeror kerkon, gjithashtu, nje demokraci funksionale dhe administrate transparente. Administrata nuk posedon ende burimet e nevojshme per nje pune te suksesshme, keshtu qe kontributi i bashkesise nderkombetare, perfshi ketu OSBE-ne, eshte ende shume i rendesishem.

- **Nderkaq shoqeria shqiptare po perballet me shqetesime mjaft serioze qe jane shqetesuese jo vetem per te, por edhe per rajonin...**

Keto probleme jane plaga e te gjitha vendeve ne rajon ne shkalle te ndryshme. Megjithate, qe nga vjeshta e kaluar, perspektiva rajonale dhe nevoja per perpjekje te koordinuara nderkombetare jane kuptuar me mire, duke i hapur rrugen aktiviteteve te reja dhe planifikim te nje politike rajonale te gjere. OSBE-ja, Pakti i Stabilitetit, BE-ja dhe NATO-ja kane gjetur nje bashkepunim me te gjere ne rajon. Kete vit, OSBE-ja, kryesia e radhes e se ciles mbahet nga Mbreteria e Vendeve te Ulta, i ka vene nje theks te vecante luftes kunder trafikut.

- **Disa raporte te nderkombetareve, si edhe te zyres suaj, kane treguar ne thelb se qeveria nuk eshte efektive ne luften kunder korrupsionit, kunder trafikeve te origjines dhe ato qe rrjedhin nga rajoni etj. Ne keto kushte, a mund te kerkohet nje qeverisje tjeter?**

Cdo qeveri do te ishte perballur me te njejtat probleme, si dhe me mungesen e burimeve. Sic thashe me pare, ajo qe duhet eshte nje ndryshim ne klimen politike, sidomos ne marredheniet midis qeverise dhe opozites. Vendet qe perballen me veshtiresi kane nevojte per elemente konsensuale ne politikat e tyre, ne menyre qe, ne nje fare mase, te degjohet zeri i te gjithëve edhe nga qeveria. Pa nje ndryshim ne kulturen politike, une nuk shoh ndonje ndryshim domethenes ne aftesine e vendit per te zgjidhur problemet e tij, pavaresisht se kush eshte ne pushtet.

- **Institutionet shqiptare, megjithë përvorjen dhe ndihmen e strukturave përendimore, vazhdojnë të jenë të brishta dhe nën ndikimin e pushtetit politik. Cili është opinioni juaj?**

Mungesa e transparencës, kultura e ulët e shërbimit civil dhe shoqëria e pazhvilluar civile janë faktorët kryesorë që bëjnë një situatë të tillë të mundur.

- **Kohët e fundit, ka një seri gjyqesh të zyrtarëve të lartë ndaj mediave opozitare dhe gazetarëve larg qeverisë. A jeni në dijeni të këtyre proceseve dhe a keni ndonjë objeksion?**

Po, jemi në dijeni dhe po i ndjekim me shumë kujdes. Në ditë, gjithashtu se Kodi Penal përmban disa nene që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen. Disa prej tyre ofrojnë një mbrojtje të vecantë për zyrtarët e lartë dhe simbolet. Në këtë kontekst, unë do të doja të kujtoja fjalët e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Shtypit, i cili, kohët e fundit, shprehu bindjen e tij se zyrtarëve publikë, që duhet të ushtrojnë një nivel më të madh tolerancë ndaj kritikës se sa qytetarët e zakonshëm nuk duhet t'u jepet asnjë mbrojtje e vecantë. Ai tha, gjithashtu, se asnjë gazetar nuk duhet dënuar me burgim për atë që ai shkruan dhe, në një demokraci, të shkruash rreth aktivitetëve të nepunësve publikë është pjesë e punës së gazetarit. Këto parime janë të përfshira edhe në Deklaratën e Londrës për Sfidat ndaj Lirisë së Shtypit, nëntor 2000, që thotë se shfuqizimi i ligjeve penale për shpifje në favor të ligjeve civile duhet të merret në konsideratë, në përputhje me standartet ndërkombëtare përkatëse. Gjithashtu, Shteti, objekte si flamuj apo simbole, organizma qeveritare dhe autoritete publikë të të gjitha llojeve duhet të ndalohen të ngrenë akuza për shpifje; ligjet që sigurojnë mbrojtje të vecantë për figurat publikë duhet të shfuqizohen dhe askush nuk duhet të jetë përgjegjës sipas ligjit për shpifje për shprehjen e një opinioni. Do të dëshiroja, gjithashtu, të theksoja se një media e pavarur dhe pluraliste është thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur, si dhe për sisteme përgjegjëse qeverisëje.

- **Tani të vijmë tek një pjesë e fokusit të punës suaj: a ju duket Shqipëria dhe institucionet e saj të vetëmjaftueshme në fushën e sigurisë?**

Në botën e sotme, nuk ka asnjë shoqëri që të jetë e vetëmjaftueshme në fushën e sigurisë. Çdo komb ka nevojë për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e sigurisë. Kapaciteti i Shqipërisë në këtë fushë po rritet ngadalë falë bashkëpunimit intensiv me organizatat kryesore të sigurisë dhe vende të tjera.

- **Disa politikane të lartë kanë kërkuar ngushtimin e pranisë së OSBE-së në Shqipëri, opinioni juaj?**

Ajo çka është e rëndësishme këtu është që në kemi marrë mbështetje të plotë nga qeveria për aktivitetet e ristrukturuara të Prezencës. Kryeministri Nano perseriti kohët e fundit mbështetjen e tij për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, kryetari i opozitës, Dr. Berisha, gjithashtu, po i jep mbështetjen e tij Prezencës dhe puna që ne po bëjmë në bashkëpunim me qeverinë dhe pjesën tjetër të shoqërisë po shkon mirë. Mendoj se kjo është ajo që ka rëndësi.

- **8. Çfarë vlerësoni si pozitive në punën e komisionit dypalësh?**

Une e kam theksuar ne disa raste se komisioni dypalesh eshte nje histori suktesi e politikes se fundit shqiptare, sepse perfaqesoi hapjen ndaj normalizimit te kultures politike, dha mesime te dobishme per situata ku te gjitha te mbeten te kenaqur dhe tregoi menytrat se si te kombinosh ekspertizen me dijet politike.